



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2020:084042

Datë: 02.02.2021

Numri i dokumentit: 01463989

P.nr.708/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me procesmbajtësen Bahrije Smakolli, në çështjen penale në rivendosje, kundër të pandehurit B. Sh. nga fshati B. komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.3293/19 e datës 02.07.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 14.10.2020, në praninë e Prokurorit të Shtetit Dusko Manitaseviq, të pandehurit Bekim Shabani, përfaqësuesit të palës së dëmtuar Sektori i Pylltarisë, F. F. me autorizim, pas shpalljes së aktgjykimit me datë 01.02.2021, me datë **02.02.2021** përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI, B. Sh. nga i ati I. e ëma Z. e vajzërisë M. i lindur me ... ne fshatin Sh. komuna e Vushtrrisë, ku edhe banon, me nr. Personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, ka të kryer 7 klasë të shkollës fillore, i martuar, prind i 6 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike – rast social, edhe më parë i dënuar për vepra penale të kësaj natyre përmes aktgjykimeve të plotfuqishme dhe atë, P.nr.327/2005; P.nr.59/2011, P.nr.54/2013, P.nr. 35/2012, P.nr.151/2001, P.nr.628/2018, 25.03.2019; P.nr.178/2018, P.nr. 258/18, P.nr.977/19, P.nr.1184/2019, 19.02.2020; P.nr.1030/2019, P.nr. 44/2020, P.nr. 835/2019.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 15.10.2017, rreth orës 17:50 ne Pyllin – pronë e Komunës në territorin e fshatit Sllakoc, në vendin e quajtur “B. Xh., është zënë duke i prerë drutë, 118 trungje të sasisë totale 7.08m³, lloji i drurit “bungu” të diametrit 14-16 cm, lartësisë 7m, ku dëmi total është në vlerë prej 637.20 euro, këtë dhe të njëjtat i ka transportuar pa dokumentacion përkatës.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 41, 43, 45, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 74 dhe neni 358 par.2 të KPRK-së si dhe nenit 365,dhe 450, 463 të KPPK-së.

GJYKON

Me **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej 10 muaj dhe me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 1000 € (njëmijë euro), të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 2 (dy) vite nuk kryen vepër tjetër penale.

DETYROHET i pandehuri që palës së dëmtuar Komuna e Vushtrrisë – Sektori i Pylltarisë të ia paguaj dëmin material në shumën prej gjashtëqindetridhjeteshtatë euro e njëzet cent (637.20 €).

DETYROHET i pandehuri, që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30 €).

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzet euro (20€).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP-II.nr.3293/19 e datës 02.07.2020, kundër të pandehurit B. Sh. nga fshati B. komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par.2 të KPRK-së, e plotësuar me datë 14.10.2020.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me date 01.02.2021 në të cilën seancë i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë, ndjehet i penduar për veprën e kryer dhe i premtton Gjykatës se nuk do të përsërisë veprën penale të kësaj natyre apo natyrës tjetër.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se në bazë të nenit 248 par.2 të KPPK-se pranimi i fajësisë nga ana e të njëjtës është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kurrfarë presioni dhe atë pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë. E njëjti i propozoi gjykatës që ta bëjë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç ‘rast janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore, ku me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar që vepra penale është kryer ashtu siç parashihet në dispozitiv të aktakuzës dhe në të njëjtën kohë i propozoi gjykatës që pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ta merr si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit, njëherit kërkoi nga gjykata që të pandehurit ti shqiptojë një dënim sa më të lehtë për faktin se i njëjti shihet se nuk ka edhe gjendje të mirë shëndetësore.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar Komuna e Vushtrrisë – Sektori i Pylltarisë e përkrahu fjalën e prokurorit të shtetit dje kërkoi nga gjykata që ta detyrojë të pandehurin të ia paguaj palës së dëmtuar dëmin material në shumën prej 637.20 €.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 248 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkellje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri.

Provat e administruara dhe të vlerësuara në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: Fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit e datës 02.06.2018, Procesverbali me numër 151/18 të datës 19.06.2018 si dhe shkresat tjera të lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale, e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që e kanë kryer të pandehurit. Andaj mbi këtë bazë gjykata ka vlerësuar këto prova dhe deklaratimet mbi pranimin e fajësisë i ka vlerësuar dhe pranuar.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo vepër penale është e sanksionuar me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, gjykata duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ku si rrethanë rënduese kjo gjykatë ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të pandehurit në kryerjen e veprës penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur – dëmin e shkaktuar në mjedis, si dhe duke marrë parasysh se i njëjti është i gjykuar edhe më parë përmes aktgjykimeve, P.nr.327/2005; P.nr.59/2011, P.nr.54/2013, P.nr. 35/2012, P.nr.151/2001, P.nr.628/2018, 25.03.2019; P.nr.178/2018, P.nr. 258/18, P.nr.977/19, P.nr.1184/2019, 19.02.2020; P.nr.1030/2019, P.nr. 44/2020, P.nr. 835/2019, të gjitha këto rrethana konsistojnë në inkriminimin e të pandehurit në kryerjen e kësaj veprë penale. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri pas kryerjes së veprës penale ka pasur sjellje të mirë dhe ka bashkëpunuar me gjykatën, dhe nuk ka përsëritur vepra penale të kësaj natyre, ka pranuar fajësinë si dhe ka shprehur keqardhje për veprën e kryer, ku i njëjti ka premtuar që nuk do të kryej më vepra të ngjashme ose të tjera penale, i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike është prind i gjashtë fëmijëve dhe mbajtës i familjes.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se, edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPPK-së.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar Komuna e Vushtrrisë gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par 2 të KPPK-së, ku është përcaktuar se “Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”. Në rastin konkret për gjykatën vlera e dëmit e përcaktuar nga Komuna e Vushtrrisë përmes shkresës zyrtare të datës/ vlerësimit Nr.151/18 të datës 19.06.2018 ishte e besueshme, dhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.708/20, datë 02.02.2021

Procesmbajtësja
Bahrije Smakolli

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.